



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

**UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.01/2026 PËR ORGANIZIMIN
DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË PËRBASHKËT TË KOMUNËS SË
MITROVICËS SË JUGUT DHE KOMUNËS SË MITROVICËS SË
VERIUT**

Udhëzimi Administrativ (MAPL) Nr. 01/2026 për Organizimin dhe Funksonimin e Bordit të Përbashkët të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut, është miratuar nga Ministri i MAPL-së me datë: 23.04.2026.

Në pajtim me nenin 93, (4), nenin 123 dhe 124, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 11, paragrafit 1, nënparagrafi 1.5, të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës (GZ, Nr. 34/2022, 18.11.2022), nenin 17, të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, (GZ, Nr.28/2008, 04.06.2008), nenin 7 dhe 8, të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave (GZ, Nr.26/2008, 02.06.2008), nenin 16, pika 2, e Ligjit Nr. 04/L-115 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjeve që kanë të bëjnë me Përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë së Kosovës (GZ, Nr.25/2012,07.09.2012), nenin 16, paragrafi 1, pika 1.1, të Rregullores (QRK) Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, nxjerr:

UDHËZIM ADMINISTRATIV (MAPL) NR.01/2026 PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E BORDIT TË PËRBASHKËT TË KOMUNËS SË MITROVICËS SË JUGUT DHE KOMUNËS SË MITROVICËS SË VERIUT

Neni 1 Qëllimi

Ky Udhëzim Administrativ ka për qëllim të rregullojë organizimin, funksionimin dhe kompetencat e bordit të përbashkët të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Neni 2 Fushëveprimi

Dispozitat e këtij Udhëzimi Administrativ zbatohen nga Komuna e Mitrovicës së Jugut, Komuna e Mitrovicës së Veriut, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe bordi i përbashkët.

Neni 3 Përkufizimet

1. Shprehjet dhe shkurtesat e tjera të përdorura në këtë Udhëzim Administrativ e kanë kuptimin si në vijim:
 - 1.1. **Ministria** - nënkupton Ministrinë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale sipas Ligjit për Vetëqeverisje Lokale;
 - 1.2. **Bordi** - nënkupton bordin e përbashkët të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut, i themeluar në pajtim me nenin 7, paragrafi 7.1, të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave;
 - 1.3. **Kryesuesi** - nënkupton personin përgjegjës të emëruar nga Kryeministri, i cili e kryeson punën e bordit të përbashkët të Komunës së Mitrovicës së Jugut dhe Komunës së Mitrovicës së Veriut.

Neni 4

Përbërja dhe emërimi i anëtareve të bordit

1. Bordi përbëhet nga njëmbëdhjetë (11) anëtarë.
2. Komuna e Mitrovicës së Jugut përfaqësohet me pesë (5) anëtarë:
 - 2.1 Kryetari i komunës;
 - 2.2 Tre (3) drejtorë ose zyrtarë përgjegjës nga administrata e komunës;
 - 2.3 Një (1) përfaqësues nga shoqëria civile.
3. Komuna e Mitrovicës së Veriut përfaqësohet me pesë (5) anëtarë:
 - 3.1. Kryetari i komunës;
 - 3.2. Tre (3) drejtorë ose zyrtarë përgjegjës nga administrata e komunës;
 - 3.3. Një (1) përfaqësues nga shoqëria civile.
4. Përfaqësuesit e komunave i emëron dhe i shkarkon kryetari i komunës përkatëse ndërsa Kryesuesi emërohet dhe shkarkohet nga Kryeministri i Republikës së Kosovës.

Neni 5

Përgjegjësitë e bordit

1. Koordinon ushtrimin e kompetencave vetanake të komunave të përcaktuara në Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, në veçanti në fushat që kërkojnë bashkërendim ndërkomunal, si zhvillimi ekonomik lokal, planifikimi urban dhe rural, mbrojtja e mjedisit dhe ofrimi i shërbimeve publike.
2. Shqyrton dhe propozon iniciativa të përbashkëta për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve publike për qytetarët e të dy komunave, në përputhje me parimet e efikasitetit, transparencës dhe barazisë.
3. Lehtëson dhe promovon bashkëpunimin ndërkomunal përmes hartimit të rekomandimeve për marrëveshje ndërkomunale në fusha të interesit të përbashkët.
4. Identifikon çështje me interes të përbashkët ndërmjet komunave dhe jep rekomandime për zgjidhjen e tyre në mënyrë të koordinuar.
5. Kontribuon në harmonizimin e politikave lokale dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor lokal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Monitoron zbatimin e marrëveshjeve ndërkomunale dhe jep rekomandime për përmirësimin e tyre.
7. Nxiti përfshirjen e qytetarëve dhe grupeve të interesit në proceset konsultative për çështje që kanë ndikim ndërkomunal.
8. Bashkëpunon me institucionet qendrore dhe organizata të tjera relevante për realizimin e projekteve të përbashkëta ndërkomunale.

9. Marrëveshjet e bashkëpunimit ndërkomunal në mes komunave të iniciuara sipas rekomandimeve të bordit lidhen në pajtim me Ligjin përkatës për Bashkëpunim Ndërkomunal

Neni 6 Përgjegjësitë e Kryesuesit

1. Thërret dhe kryeson mbledhjet e bordit si dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës së bordit.
2. Siguron koordinimin efektiv ndërmjet komunave pjesëmarrëse për ushtrimin e kompetencave vetanake në fusha me interes të përbashkët.
3. Përfaqëson bordin në raport me institucionet qendrore dhe organizatat e tjera relevante, në kuadër të bashkëpunimit ndërinstytucional dhe ndërkomunal.
4. Siguron që puna e bordit të zhvillohet në përputhje me parimet e transparencës, llogaridhënies dhe përfshirjes së publikut.
5. Mbikëqyrë zbatimin e vendimeve dhe rekomandimeve të bordit si dhe kërkon raportim periodik nga komunat përkatëse për zbatimin e tyre.
6. Siguron mbajtjen e procesverbaleve dhe dokumentimin e punës së bordit, si dhe publikimin e vendimeve në përputhje me legjislacionin në fuqi.
7. Mund të propozojë themelimin e grupeve punuese për trajtimin e çështjeve specifike me interes të përbashkët ndërkomunal.

Neni 7 Konstituimi i bordit

1. Kryetarët e komunave janë të obliguar të i emërojnë anëtarët e bordit nga komuna e tyre përkatëse, brenda tridhjetë (30) ditëve pas hyrjes në fuqi të këtij Udhëzimi Administrativ.
2. Me ftesë të Kryesuesit, mbledhja konstituive mbahet brenda tridhjetë (30) ditëve nga emërimi i anëtarëve të bordit.
3. Pas përfundimit të zgjedhjeve të rregullta lokale, kryetarët e komunave janë të obliguar të caktojnë anëtarët e bordit nga komuna e tyre përkatëse, brenda tridhjetë (30) ditëve pas marrjes së mandatit të tyre si kryetar.

Neni 8 Mandati

1. Mandati i Kryesuesit të bordit, është katër (4) vjet dhe lidhet me mandatin e Kryeministrit.
2. Mandati i anëtarëve të bordit është katër (4) vjet dhe lidhet me mandatin e kryetarëve të komunave.

Neni 9
Ftesa dhe materiali për mbledhjen e bordit

1. Ftesa për mbledhje të rregullta të bordit ju dërgohet të gjithë anëtarëve, pesë (5) ditë para mbajtjes së mbledhjes. Bashkë me ftesën dërgohet edhe materiali për pikat e rendit të ditës që do të shqyrtohen në mbledhje.
2. Bordi mundë të mbajë mbledhje të jashtëzakonshme. Ftesa për mbledhje të jashtëzakonshme të bordit i'u dërgohet të gjithë anëtarëve, një (1) ditë para mbajtjes së mbledhjes. Bashkë me ftesën dërgohet edhe materiali për pikat e rendit të ditës që do të shqyrtohen në mbledhje.

Neni 10
Mbledhjet e bordit dhe rendi i ditës

1. Bordi mban së paku katër (4) mbledhje të rregullta brenda vitit, ose së paku çdo tre (3) muaj nga një (1) mbledhje.
2. Rendi i ditës për mbledhjet e bordit, caktohet nga Kryesuesi. Anëtarët e bordit mund të propozojnë pika për rend të ditës. Kryesuesi përfshinë në rendin e ditës propozimet e arsyetuara të anëtarëve.
3. Rendi i ditës miratohet nga bordi në fillim të mbledhjes, sipas procedurës së paraparë në nenin 11 dhe 12 të këtij Udhëzimi Administrativ.
4. Mbledhjet e bordit mbahen në territorin administrativ të dy (2) komunave, me rotacion, një (1) mbledhje mbahet në Komunën e Mitrovicës së Jugut ndërsa mbledhja tjetër në Komunën e Mitrovicës së Veriut.
5. Bordi mund të vendos që mbledhjet të mbanë edhe në ndonjë lokacion tjetër të përshtatshëm, apo në hapësirat e Ministrisë.

Neni 11
Kuorumi

1. Kuorumi për mbajtjen e takimeve të bordit arrihet kur janë të pranishëm së paku gjashtë anëtarë dhe Kryesuesi.
2. Çdo anëtarë nga komunat respektive, duhet ta njoftojë kryetarin e komunës së tij për arsyet e mospjesëmarrjes në mbledhjen e bordit.
3. Kryetari i komunës për arsyet nga paragrafi 2 i këtij neni njofton bordin dhe Kryesuesin.
4. Në qoftë se me shumicën e votave të bordit vlerësohet që mos pjesëmarrja nuk është e arsyetueshme kurse në rend dite gjenden pika për të cilat kërkohet vendimmarrje, mbledhja do të mbahet me pjesëmarrjen e shumicës së thjeshtë, pra pesë (5) anëtarë dhe Kryesuesi.

Neni 12 Votimi

1. Në të gjitha takimet e bordit, secili anëtarë ka një votë. Kryesuesi ka një votë shtesë nëse votimi është i barabartë për ose kundër një propozimi.
2. Për vendimmarrjen e bordit nevojiten së paku gjashtë vota dhe ajo e Kryesuesit.
3. Abstenimet regjistrohen për kuorum, por nuk llogariten në rezultat.
4. Atëherë kur nuk krijohet kuorumi apo pamundësohet vendimmarrja për shkak të mungesës së paarsyetuar të anëtarëve të caktuar të detyruar të paraqesin arsyet e mungesës për mospjesëmarrje sipas nenit 11 të këtij Udhëzimi Administrativ, bordi merr vendim me shumicën e thjeshtë të anëtarëve.

Neni 13 Mbështetja e bordit

Ministria siguron mbështetje administrative dhe teknike për funksionimin e bordit.

Neni 14 Mbikëqyrja e zbatimit

Mbikëqyrjen e zbatimit të këtij Udhëzimi Administrativ e bënë Ministria.

Neni 15 Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Elbert Krasniqi

Ministër i MAPL-së

23.04.2026